



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
SENATI AKADEMIK

SHESHI "NËNË TEREZA", REKTORATI I UT-së, TIRANË  
TEL. +4 2228402, FAX: +4 223981

VENDIM

Nr. 28 datë. 12.10.2016

***"Për dhënin e titullit "Doctor Honoris Causa", z. Dritëro Agolli"***

Bazuar në ligjin nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSF" neni 3, neni 38 pika 1 gërma a), neni 133 pika 2; në VKM nr.467 datë 18.7.2007 "Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për kualifikimin shkencor e pedagogjik të personelit akademik" të ndryshuar pika 2.6; si dhe në propozimin e Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës,

VENDOSI:

1. Të japë titullin "***Doctor Honoris Causa***" për zotin ***Dritëro Agolli*** me motivacionin "***Shkrimtar i shquar i letërsisë shqipe, i cili, në veprat e tij, ka pasqyruar e skalitur me mjeshhtëri të lartë, me përmbajtje humaniste, me stil e gjuhë të pasur artistike historinë dhe shpirtin e popullit shqiptar***".
2. Të caktojë reçentë Prof.Dr.Ymer Çiraku dhe Prof Dr.Bashkim Kuçuku.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

